



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALLAKASTËR
DREJTORIA EKONOMIKE DHE ÇËSHTJEVE SOCIALE

Nr 260 prot

Ballsh, më 25 / 06 2026

PROJEKT-VENDIM

Nr 38 Datë 25 / 06 2026

PËR MIRATIMIN FINANCIMIT PËR 4 (KATËR) FAMILJE NË PROGRAMIN E STREHIMIT SOCIAL, FOND I MIRATUAR ME VKB NR.51 DATË 23.12.2025 "PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2026, DOKUMENTIT PËRFUNDIMTAR TË PROJEKT BUXHETIT AFATMESËM 2026-2026 DHE NUMRIN E PËRGJITHSHËM TË PUNONJËSVE".

Mbështetur në nenet 34,40,41, 55 të ligjit Nr 139/2015 "Për Vetqeverisjen vendore", ligjin Nr 9936 datë 26-08-2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, kreu III nenet 10-20, kreu IV nenet 20-29, kreu VII nenet 39-40 të ligjit Nr 68/2017 "Për Financat e Vetqeverisjes Vendore", Ligjin Nr 87/2025 "Për Buxhetin e Vitit 2026", ligjin Nr 10296 datë 08-07-2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", vendimit të Këshillit Bashkiak nr.51 datë 23.12.2025 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2026, dokumentit përfundimtar të projekt buxhetit afatmesëm 2026-2026 dhe numrin e përgjithshëm të punonjësve", kryetari i Bashkisë i propozon Këshillit Bashkiak Mallakastër:

TË MIRATOJ:

1. Fondin e bashkëfinancimit nga të ardhurat e veta të Bashkisë në shumën 3.912.550 lekë për 4 famije të cilat i bashkangjiten listës fituese për projektin "Përmirësim i kushteve të banimit për komunitetet e pafavorizuara 2026" sipas tabelës së mëposhtme :

Drejtor i Drejtorisë ekonomike

Aleksandër Rama

Drejtor i drejtorisë juridike

Marjola Shehaj

KRYETAR
QERIM ISMAILAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
DREJTORIA E MBROJTIES CIVILE DHE TERRITORIT
SEKTORI I MBROJTIES CIVILE

Nr. 3260 / Prot.

Ballsh, më 25.06.2026

MIRATOHET

KRYETAR

Qerim Ismailaj

RELACION

MBI PROJEKT-VENDIMIN “PËR MIRATIMIN E FINANCIMIT PËR 4 (KATËR) FAMILJE NË PROGRAMIN E STREHIMIT SOCIAL, FONDI I MIRATUAR ME VKB NR.51 DATË 23.12.2025 “PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2026, DOKUMENTIT PËRFUNDIMTARPË PROJEKT BUXHETIT AFATMESEM 2026-2028 DHE NUMRIN E PËRGJITHSHËM TË PUNONJËSVE ”.

Të nderuar këshilltarë!

Projekt Vendimi “Për miratimin e financimit për 4 (katër) familje në programin e strehimit social, fondi i miratuar me VKB nr.51 datë 23.12.2025 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2026, dokumentit përfundimtar për projekt buxhetit afatmesëm 2026-2028 dhe numrin e përgjithshëm të punonjësve”, është hartuar në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Ligjit me nr. 22/2018 “Për strehimin social”, i ndryshuar Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.384 datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutur strehim, sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, shkresës së Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit nr. 628/2 prot., datë 23.01.2026 "Mbi fondet për programet e strehimit për vitin 2026", VKB nr. 51, datë 23.12.2025 “Për miratimin e buxhetit të viti 2026, dokumentit përfundimtar të projekt buxhetit afatmesëm 2026 – 2028 dhe numrit të përgjithshëm të punonjësve”, VKB nr. 13, datë 28.02.2026 “Për miratimin e listës dhe fondin e bashkëfinancimit të familjeve që do të përfitojnë nga programi i strehimit : Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e pafavorizuara”

Strukturat e Bashkisë Mallakastër kanë kryer evidentimet e familjeve të cila plotësonin kriteret për përfshirjen në programin e përmirësimit kushteve të banimit për komunitetet e pafavorizuara dhe në total sipas VKB së sipërcituar u përfshinë 27 (njëzetë e shtatë) familje.

Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë janë kualifikuar 18 tetëmbëshjetë) familje të cilat do të përfitojnë nga zbatimi i programit të sipërcituar.


Nga 9 familjet e skualifikuara, referuar evidentimeve të kryera dhe nevojave për ndërhyrje emergjente si dhe disponibilitetit financiar të Bashkisë Mallakastër, 4 familje do të përfitojnë nga fondi i bashkëfinancimit nga të ardhurat e veta të Bashkisë Mallakastër prej 3 912 550 (tremilion e nëntëqind e dymbëdhjetëmijë e pesëqind e pesëdhjetë) lekë.

Familjet përfituese janë si më poshtë:

- 1-Zini Sinaj, fshati Ngraçie, Nj/Adm. Qëndër.
- 2-Pëllumb Aderaj, fshati Aranitas, Nj/Adm. Aranitas.
- 3-Sali Alushaj, fshati Drenovë, Nj/Adm. Qëndër.
- 4-Azire Jaupaj, fshati Gjerbës, Nj/Adm. Selitë.

Sp/ M.Civile

Lame Zotaj



P/Sek M.Civile

Izet Ymeraj



P/Sektorit Juridik

Nertil Sakaj

